



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**ZP. Anr.45/2026**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli - kryesues, Hidajete Gashi Alaj dhe Ramush Bardiqi - anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Jovan Denic nga Subjekti Politik Srpska Lista, për shkak të parregullsive për ditën e votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të datës 7 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.06.2026, merr këtë :

#### **V E N D I M**

**REFUZOHET E PABAZUAR** ankesa ZP.Anr.45/2026, të datës 09.06.2026, e parashtruar nga Jovan Denic nga Subjekti Politik Srpska Lista, për shkak të parregullsive për ditën e zgjedhjeve, në ditën e votimit për Zgjedhjet Parakohshme për Kuvend të Kosovës, të mbajtura më datë 7 Qershor.2026.

#### **A r s y e t i m**

Me datë 09.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën ZP.Anr.45/2026, parashtruar nga Jovan Denic nga Subjekti Politik Srpska Lista, në të cilën pretendohet se më datë 08.06.2026 në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), gjatë numërimit të votave nga vendvotimi VV 3501/02, në mes orës 12:00 dhe 13:00, ka vërejtur se votat e Subjektit Politik Srpska Lista u shpallën të pavlefshme me arsyetimin se tek subjekti politik ishte shënuar me këto simbole: +, /, //, °, ,, √. .

Më tej në ankesë theksohet se konsiderojnë se subjekti i tyre politik është dëmtuar, sepse në fletëvotime shihet qartë qëllimi i votuesit dhe se në këtë mënyrë po shtrembërohet vullneti i votuesve.

Si prove rekomandon vërtetimin e kamerave nga tavolina e lartcekur si dhe dëshmitarët e mundshëm Jovan Denić, Vladan Trajković, Dalibor Ilić, dhe Bekim Maliqi.

Në përgjigjen në ankesë të KQZ-së, sqaron se bazuar në nenin 3, paragrafi 1.38 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar. Po ashtu, sipas nenit 5, paragrafi 1.4 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër

funksonet e QKN përfshihet edhe numërimi i fletëvotimeve dhe votave të kandidatëve të subjekteve politike.

Më tej në përgjigje KQZ, thekson se në lidhje me vlefshmërinë e fletëvotimeve, neni 16, paragrafi 2 i Rregullores Zgjedhore Nr. 12/2024, Votimi, Numërimi në Vendvotim dhe Menaxhimi i Vendvotimit, përcakton se një votë është e vlefshme kur është shënuar vetëm një subjekt politik dhe kuptohet qartë vullneti i votuesit. Në të kundërtën, vota konsiderohet e pavlefshme nëse: janë shënuar më shumë se një subjekt politik, nuk është shënuar «asnjë subjekt politik, janë shënuar vetëm kandidatët, por jo subjekti politik, qëllimi i votuesit nuk është i qartë.

Për më tepër, sipas nenit 16, paragrafi 6 të Rregullorës Zgjedhore Nr. 12/2024, nëse anëtarët e KVV-së nuk arrijnë të pajtohen lidhur me atë se a është vota e vlefshme apo i pavlefshme, atëherë kryesuesi merr vendimin përfundimtar përkritazi me atë votë dhe këtë rast e evidenton në librin e votimit.

Në Procedurën e votimit dhe numërimit në vendvotim, të miratuar nga KQZ me dt. 23.05.2026, nr. 01/955-2026, parashihen shembujt e fletëvotimeve të vlefshme dhe të pavlefshme për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 7 qershor 2026.

Gjatë shqyrtimit të ankesës, është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme (fletëvotime ose prova të tjera) që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj, të paraqitura në ankesë.

KQZ, njofton se i gjithë materiali zgjedhor duke përfshirë edhe kamerat e sigurisë, momentalisht gjendet në QKN të komunës së Ranillugut, mirëpo pas përfundimit të gjithë procesit të punës së QKN i njëjti material zgjedhor dorëzohet nga QKN në Qendrën e Numërimit dhe Rezultateve -QNR, dhe të njëjtat mund të verifikohen dhe hetohen nga PZAP dhe organet e drejtësisë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore, përgjigjeve në ankesë, gjeti se:

**-Ankesa është e pabazuar.**

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjeve në ankesë, vlerësoj se pretendimet e Jovan Denic nga Subjekti Politik Srpska Lista, janë të paqëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë nuk është arritur që të vërtetohen se ka pasur parregullsi në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN), gjatë numërimit të votave nga vendvotimi VV 3501/02, ashtu siç pretendohet në ankesë.

Pretendimi ankimor i ankuesit se ka vërejtur se votat e Subjektit Politik Srpska Lista u shpallën të pavlefshme me arsyetimin se tek subjekti politik ishte shënuar me këto simbole: +, /, //, √, këto pretendime janë të pa bazuara, pasi që në ankesën e parashtruesit të ankesës nuk ka prova lidhur me këtë pretendim ndërsa Qendra Komunale e Numërimit (QKN) është institucioni përgjegjës për numërimin e fletëvotimeve në mënyrë transparente, në prani të vëzhguesve dhe personave të tjerë të akredituar.

Po ashtu, sipas nenit 5, të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 Qendra Komunale e Numërimit, ndër funksionet e QKN, paragrafi 1.3 *parasheh* “bën verifikimin e votave të subjekteve politike”.

Pretendimi ankimor se janë përdorur shenja identifikuese në fletëvotimet e Subjektit Politik Srpska Lista, dhe se të njëjtat fletëvotime janë shpallur të pavlefshme, këto pretendim janë supozime, dhe njëherit nuk ka asnjë provë materiale të bashkangjitur në ankesën e ankuesit, ndërsa lidhur me këtë pretendim ankimor ankuesi ka pasur mundësi për të paraqitur prova në kohën kur është publikuar fletëvotimi në QKN.

Paneli vlerëson se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtruesit e ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me prova konkrete, të ligjshme se ka mospërputhje të votave.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtruesit e ankesës nuk kanë bashkangjitur prova bindëse, apo ndonjë dëshmi, me të cilën do të vërtetoheshin këto pretendime, andaj nuk mund të vërtetohej se ka shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Andaj neni 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, përcakton se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesit e ankesës në mbështetje të pretendimeve të tyre, nuk kanë ofruar asnjë provë si dëshmi, edhe pse në bazë të nenit 117 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin nen përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nisur nga arsyet e theksuara më lartë, e në kuptim të nenit 117 par. 3, 118 par. 1 dhe 119 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

## **PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**

**ZP.Anr.45/2026 datë 12.06.2026**



**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.